



Republika e Kosovës
Komuna Drenas(Gllogoc)
Kuvendi Komunal

Nr. 02.400-29750 dt. 31 05 2023



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, pika 40.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 16, pika 11 të Ligjit Nr.08/L-198 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.05.2023 miratoi këtë:

VENDIM
RIALOKIM I MJETEVE FINANCIARE

Neni 1.

Vendim për rialokim të mjeteve financiare brenda nënprogramit Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30).

Neni 2.

Rialokimi i mjeteve bëhet nga projekti “Zgjerimi i QMF Arllat”, kodi 52311, në shumën 45,000.00 euro, burimi i financimit Grande Qeveritare (10) në Projektin “Veturë e ndihmës së shpejtë QKMF Drenas”, kodi 53726, burimi i financimit Grande Qeveritare (10), në shumën prej 45,000.00 euro.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 4.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Elia Hajdari

A r s y e t i m

Meqenëse Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës është në procedurë të finalizimit dhe qendra e AMF në Arllat i plotëson kriteret për ofrim të shërbimeve shëndetësore sipas numrit të banorëve resident si dhe duke parë nevojën për vettura të ndihmës së shpejtë të cilat janë tejte të vjetruara dhe jo funksionale, ky projekt të rialokohet për blerjen e një veture.